## Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020.

(Të gjitha balancat janë në lekë).

### 1. Informacione të përgjithëshme

'BROTECH BRANDS" SH.P.K eshte regjistruar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 5 Gusht 2015. Kapitali I regjistruar eshte 1'000'000 leke dhe zoterohet nga ortaket dhe themeluesit, Marin Pahija 50% dhe Faolt Pahija 50%. Veprimtaria tregtare e shoqerise eshte: "Import-eksport, tregtimin me shumice dhe pakice te gjithe artikujve elektrike, elektronike, te gjitha llojet e mallrave industrial dhe teknologjik, sherbime transporti, projektim zbatim, asamblim produktesh."

### 2. Përmbledhje e politikave dhe parimeve kontabël

- **Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare (PF) janë përgatitur në përputhje me ligjin nr. 9228 dt 29.04.2004 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë pergatitur mbi bazen e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elementë të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të kostatuara. PF-të paraqiten në monedhën vendase, Lek Shqiptar (lek).

- **Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar bleresit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftushme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogariten me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëhere kur ato sigurohen prej të treteve dhe në të njejtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura.

- **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit kur nuk jepet ndryshe. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, në dt 31.12.2020 janë:
**1 EUR= 123.7LEKË**
**1 USD= 100.84 LEKE**

- **Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem
Tatim fitimi i pagueshëm ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korigjohet me shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal.

- **Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

- **Pasivet financiare**

Huatë e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale, kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

- **Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivet afatgjata materiale(AAM) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar minus humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nëse në periudhat paraardhëse nuk ka një tepricë nga rivlersimi për këtë aktiv. Amortizimi është llogaritur sipas klasave të AAM. Normat e amortizimit janë në perputhje me dispozitat ligjore dhe SKK.

- **Gjendjet e inventarit**

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes plus të gjitha shpenzimet për të sjellë inventarët në kushte magazinimi, shpenzime këto që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së inventarëve. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit, që nga drejtimi është çmuar si vlera neto e realizueshme.

3. **Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)**

Gjendjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në lekë dhe valutë, në datat 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 janë si më poshtë:

| Emertimi i Llogarise | Monedha | Gjendja ne 31.12.2020 | | Gjendja ne 31.12.2019 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Neë lekë | Në valute | Në leke | Në valute |
| Llogari bankare në lekë | LEK | 137,745 | - | 30,180 | - |
| Llogari bankare në euro | LEK | 249,310 | € 2,015.44 | 8,245 | € 67.70 |
| Llogari bankare në usd | LEK | 7,698 | $76.34 | 10,588 | $397.46 |
| Arka në lekë | LEK | 381,936 | | 26,727 | |
| Shuma | | 776,689 | x | 75,740 | x |

Gjendjet e llogarive të likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave.

Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të dt. 31.12.2020 të Bankës së Shqipërisë.
Gjëndja e likuiditeteve do te perdoret per pagesat e detyrimeve ne periudhen e ardhme.

## 4. Te drejta te arketueshme

Kërkesat e arkëtueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2020 deklarohen si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Të drejta të arkëtueshme : | | |
| 1.Nga aktiviteti i shfrytëzimit | 13,361,038 | 11,685,109 |
| 2.Nga njësitë ekonomike brenda grupit | 0 | 0 |
| 3.Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | 0 | 0 |
| 4.Tatim fitimi | 0 | 0 |
| 5.Te drejta te tjera te arketueshme | 13,404,334 | 490,315 |
| 6. Kapital i nënshkruar i papaguar | 0 | 0 |
| Shuma | 26,765,372 | 12,175,424 |

Në zerin "Nga aktiviteti i shfrytezimit" në shumën 13.361.038 lekë janë paraqitur detyrimet e klientëve ndaj shoqërisë, gjëndje dt 31.12.2020. Ne zerin "Te drejta te tjera te arketueshme" ne shumen 131.339 .jane paraqitur tepricat me date 31.12.2020 te TVSH nga leasing ne shumen 39.638, e cila eshte nje e drejte e arketueshme qe amortizohet me faturimin e kesteve te qerase financiare,dhe Teprica ne llogarine e Doganes ne shumen 38.601, ,Llogari te perkoheshme ne pritje 53.100.

## 5. Inventari

Gjendjet e inventarit në fillim dhe në fund të ushtrimit paraqiten:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| **Inventarët:** | | |
| 1.Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme | - | - |
| 2.Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte | - | - |
| 3.Produkte të gatshme | - | - |
| 4.Mallra | 66,200,870 | 68,920,645 |
| 5.Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri) | - | - |
| 6.AAGJM të mbajtura për shitje | | |
| 7.Parapagime për inventar | 728,003 | 258,678 |
| Shuma | 66,928,873 | 69,179,323 |

Vlerat e inventarit të paraqitura më sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimit fizik të kryer në fund të vitit ushtrimor 2020 . Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit të përhershëm. Si politike kontabël në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda e "mesatares së ponderuar". Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2020 është lekë.

| | | |
|---|---|---|
| Gjëndja më | 01.01.2020 | 68.920.645 lekë. |
| Blerje Gjatë vitit | . | 48.170.578 lekë. |
| Dalje jashte perdorimit | | 1.296.303 leke |
| Gjendja më | 31.12.2020 | 66.200.870 lekë. |

Kostoja e mallrave të shitura lekë 49.594.050 leke

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur është vlera më e ulët mes kostos së marrjes së inventarit dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevoja për zhvleresime të tij.

Zeri Parapagime per inventar perfshin parapagimin e bere per Kompanine Guandong dhe Lorefar sr Barcelone dhe Zhongzhang ,furnizim i cili ka ardhur ne vitin 2021

## 6. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Gjëndja dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqitet ne aneksin nr 4 bashkengjitur me pasqyrat financiare
Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2020.
Si politikë kontabël për kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SNK-5).
Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar minus humbje të akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëjta me ato që përdoren për qëllime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efekte fiskale.

## 7. Detyrime afatshkurtëra-Huamarrjet

Huamarrje afateshkurtëra ndaj institucioneve te kredise në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2020 shoqëria nuk ka.

## 8. Detyrime afatshkurtëra

Huatë dhe parapagimet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2020 paraqiten si vijon:

| | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020 | Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| **Detyrime afatshkurtra:** | | |
| 1.Titujt e huamarrjes | | |
| 2.Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | | |
| 3.Arkëtime në avancë për porosi | 1,166,668 | 91,667 |
| 4.Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 29,137,614 | 34,808,372 |
| 5.Dëftesa të pagueshme | | |
| 6.Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit | | |
| 7.Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjes | 12,607,624 | 24,475,945 |
| 8.Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore | 1,067,143 | 1,116,109 |
| 9.Të pagueshme për detyrimet tatimore | 1,802,645 | 1,003,365 |
| 10.Të tjera të pagueshme | 270,000 | 180000 |
| Shuma | 46,051,694 | 61,675,458 |

(i)"Arketime ne avance per porosi" pasqyron parapagimet nga ana e klienteve per furnizime qe i perkasin periudhes se ardhme.

(ii)"Të pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, detyrime këto që gjenden pa u likujduar në fund të vitit ushtrimor 2020. Shoqëria ka bërë rakordime me furnitorët dhe shuma e llogarisë sintetike është e barabarte me shumën e llogarive analitike të mbajtura për cdo furnitor. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitorëve janë të vleresuara realisht.

(iii)"Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrese" perfaqeson vleren e dividentit te paterhequr akoma nga ortaket, e cila paraqitet si detyrim afatshkurter i kompanise ndaj ortakeve.

(iv) "Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqerore" gjëndje më 31.12. 2020 në shumën 754.255 lekë përfaqëson pagat e vitit 2020 të cilat do të paguhen në vitin 2021, si dhe sigurimet shoqerore shendetesore dhe tatim mbi te ardhurat te muajit dhjetor 2020.

(iii) "Detyrimet tatimore" përfaqësojnë Tatimi i mbajtur ne Burim ne shumen 33.530 leke.,dhe TVSH 569.437,si edhe detyrim per Tatim Fiimin ne vleren 1.199.678 leke.
Ndersa zeri Detyrime te tjera per vleren 270.000 jane detyrime per pagese qeraje

## 9. Detyrime Afatgjata

Zeri "Detyrime ndaj Institucioneve te kredise" ne shumen 17.548.333 perfaqesohet nga titujt e borxhit si me poshte:

| | | |
|---|---|---|
| Overdrafti Credins sipas kontrates nr 9993 dt 14/12/2018 | teprica me 31.12.2020- | 4.691.260 leke |
| Kredia Credins | teprica me 31.12.2020- | 9.483.515leke |
| Kredi Sovrane BKT | teprica me 31.12.2020- | 1.361.556leke |
| Qira financiare sipas kontrates me nr.00593 dt 27/11/2015, | teprica me 31.12.2020 – | 6.667leke |
| Qira financiare sipas kontrates me nr.00914 dt 08/09/2016, | teprica me 31.12.2020 – | 224.304leke |
| Qira financiare sipas kontrates me nr. 1529 dt 27/06/2018 , | teprica me 31.12.2020– | 1.125.963leke |
| Qira financiare volswagen | teprica me 31.12.2020- | 655.068leke |

## 10. Kapitali dhe rezervat

Kapitali i rregjistruar i shoqërise, i paraqitur në bilanc, është i njëjtë me vendimet e depozituara në QKR. Me 31.12.2020 kapitali është 1,000,000 lekë, i ndare në 2 kuota me vlerë nominale 500,000 lekë /kuotë. Kapital ky që zotërohet 50% nga aksioneri Marin Pahija dhe 50% nga aksioneri Faolt Pahija.

## 11. Fitimi (humbja) e vitit

- **Të ardhurat**

Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) të biznesit paraqiten si vijon:

| | 01 Janar -31 Dhjetor 2020 | 01 Qershor -31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| **Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit** | 83,816,115 | 80,043,597 |
| Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe ı | 0 | 0 |
| Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar | 0 | 0 |
| Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | 205,319 | 118,961 |
| Shuma | 84,021,434 | 80,162,558 |

Të ardhurat nga shitja e mallrave janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të "zhveshura" nga TVSH-ja. Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

- **Shpenzimet e veprimtarisë kryesore**

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë rregjistruar me shumat e paguara ose të pagueshme.

Kostoja e punësimit, Pagat dhe Sigurimet Shoqërore&Shëndetësore, është pasqyruar saktesisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

Taksat lokale si edhe Taksa e Tatime të tjera që lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit. Sipas natyres së tyre shpenzimet e ushtrimit 2020 janë treguar në tabelat vijuese:

**Materiale të konsumuara**

| | 01 Janar -31 Dhjetor 2020 | 01 Janar -31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| **Shpenzimet e blerjes** | 0 | 0 |
| Gjendja e Mallrave ne fillim te periudhes | 68,920,645 | 58,279,740 |
| Blerje Gjate Ushtrimit | 48,170,578 | 58,895,499 |
| Dalje jashte perdorimit | 1,296,303 | |
| Gjendja e Mallrave ne fund te periudhes | 66,200,870 | 68,920,645 |
| **Kosto e mallrave te shitura** | **49,594,050** | **48,254,594** |
| | | |
| Vlera kontabel e aktive afatgjata te shitura | | |
| **Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshm** | **49,594,050** | **48,254,594** |

***Shpenzime të tjera***

| | 01 Janar -31 Dhjetor 2020 | 01 Janar -31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Blerje,energji,avull,uje | 63,869 | 321,426 |
| Karburant | 1,132,333 | 2,192,850 |
| Trajtime të përgjithshme | 226,758 | |
| Qira magazina Brotech | 705,888 | 705,888 |
| Qira Led Shop | 1,752,940 | 2,075,292 |
| Mirëmbajtje për njësitë e shitjes, të shpërndarjes | 1,552,039 | 2,246,982 |
| Sigurime njësi shitje, shpërndarje, marketim | 457,614 | 457,614 |
| Sigurime njësi administrative | | |
| Publicitet, reklama | | 293,620 |
| Transferime, udhëtime, dieta për administratën | | |
| Shpenzime postare dhe telekomunikimi | 342,747 | 390,023 |
| Tekefon dhe postare | | |
| Shpenzime transpoti | 189,220 | 27,277 |
| Taksa, tarifa doganore | 13,307 | |
| Takse skanimi | | |
| Taksa dhe tarifa vendore | 224,200 | 203,000 |
| Shpenzime të tjera për personelin | 6,691,353 | 10,871,317 |
| Takse automjeti | | |
| Gjoba dhe dëmshpërblime | | |
| Shpenzime të tjera korente | 6,314,418 | 1,988,374 |
| Sherbim doganor | | |
| Shuma | 19,666,686 | 21,773,663 |

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standardeve.

| | 01 Janar -31 Dhjetor 2020 | 01 Janar -31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| Shpenzime për interesa | 990,430 | 884,901 |
| Shpenzime për shërbimet bankare | 618,023 | 311,891 |
| Shpenzime financiare të tjera | | |
| Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore | 547,909 | 274,929 |
| Humbje nga azhornimi i Arkes/Bankes | | |
| Fitim nga kembimet valutore | (1,667,816) | (95,148) |
| Shuma | 488,546 | 1,376,573 |

- **Shpenzime personeli**

Kostoja e punës paraqitet si më poshtë vijon:

| | 01 Janar -31 Dhjetor 2020 | 01 Qershor -31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| **Kosto e punes** | | |
| Pagat e personelt | 10,098,862 | 9,370,104 |
| Sigurime shoqerore dhe shendetsore | 1,583,410 | 1,501,213 |
| Shuma | 11,682,272 | 10,871,317 |

**Shpenzimet e Tatimit mbi Fitimin**

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin kontabël 2019 dhe 2020 janë si vijon:

| | 01 Janar -31 Dhjetor 2020 | 01 Qershor -31 Dhjetor 2019 |
|---|---|---|
| FITIMI NETO PARA TATIMIT | 9,124,409.00 | 6,138,108 |
| SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+) | | |
| Amortizime tej normave fiskale | | |
| Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor | | |
| Humbje nga mos arketimi I debitoreve | | |
| Shpenzime qe nuk njihen Gjoba + pagesa teper<br>Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta | 383,758 | 750,301 |
| Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim) | | |
| PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-) | | |
| FITIMI (HUMBJA) TATIMORE E VITIT(I+II-III) | 9,508,167 | 6,888,409 |
| FITIMI (HUMBJA) TATIMORE PROGRESIVE(III+IV) | 9,508,167 | 6,888,409 |
| Shpenzimi i tatim fitimit | 1,426,225 | 1,033,261 |
| FITIMI/HUMBJA KONTABEL NETO E USHTRIMIT(I-V | 7,698,184 | 5,104,847 |
| FITIMI/HUMBJA TATIMORE NETO E USHTRIMIT(I-V) | 7,698,184 | 5,104,847 |

Tatim fitimi i ushtrimit është i llogaritur mbi fitimin e tatueshëm, i cili është rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar në tabelën e mësipërme.

## 12. Transaksione të palëve të lidhura

Në marrjen në konsideratë të çdo transaksioni dhe marredhenie të mundëshme, jo thjeshtë formën ligjore të tyre , shoqëria nuk ka transaksione të tjera me palët e lidhura, pervec marëdhënieve me oratkun.

## 13. Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytezimit

Asnjë ngjarje e rëndësishëme nuk ka ndodhur pas datës së mbylljes së vitit ushtrimor.

| Hartuesi I pasqyrave Financiare | Administratori I Shoqerise |
|---|---|
| Brunilda RIRA | Marin PAHIJA |

BROTECH BRANDS